Kronikë

Gjenden 3 armë dhe 1580 fishekë në një Land Rover në Portin e Durrësit, ishte 'braktisur' prej 2022-it! Në kërkim i riu nga Kosova, do i trafikonte drejt Kongos (VIDEO)

Automjeti, brenda të cilit u gjetën armët, ndodhej në port prej dhjetorit 2022. 24-vjeçari dyshohet se do kryente trafikimin drejt Kongos. Armët do t'i nënshtrohen ekzaminimeve nëse janë përdorur në ngjarje kriminale.

Redaksia
7 Qershor, 10:34 | **Përditësimi: 7 Qershor, 16:36**

Share

Tre armë zjarri dhe 1580 fishekë luftarakë janë gjetur nga policia kufitare në një automjet tip Land Rover në portin e Durrësit. Automjeti ishte 'braktisur' prej dhjetorit të vitit 2022 në sheshin e kontenierëve në port pasi dërguesi nuk ishte paraqitur për të kryer veprimet doganore.

Pasi Autoriteti i degës së Doganës në Durrës vendosi hapjen me datë 4 qershor, brenda automjetit u gjetën të fshehura në një hapësirë të përshtatur dy armë automatike, 1 pistoletë, 1580 fishekë luftarakë të kalibrave të ndryshëm dhe 12 krehra fishekësh për armë automatike dhe pistolete.

Siç shihet edhe nga videoja e policisë, armët ishin fshehur poshtë motorit, në një vend të përshtatur, dhe ishin të mbështjella me qese të zezë.

LEXO EDHE:
Durrës/ Theu xhamin e një automjeti dhe i mori me dhunë shoferit çantën me para, arrestohet 38-vjeçari

Sipas policisë, automjeti ka hyrë në Shqipëri nga Kosova përmes pikës kufitare të Morinës më datë 20 dhjetor të vitit 2022 dhe do të shkonte për në Republikën e Kongos në Afrikë. Në kërkim është shpallur një 24-vjeçar si i dyshuar që do të kryente trafikimin e armëve dhe municioneve drejt Kongos.

> *"Kontenieri ku ndodhej automjeti, ishte i mbyllur në sheshin e kontenierëve në portin e Durrësit që prej dhjetorit të vitit 2022 pasi dërguesi nuk ishte paraqitur për të kryer veprimet doganore dhe më datë 04.06.2025, Autoriteti i Degës së Doganës Durrës vendosi kryerjen e procedurës së hapjes dhe kontrollit të këtij kontenieri.*
>
> *Gjatë kontrollit fizik të ushtruar në automjetin Land Rover shërbimet e Policisë konstatuan në brendësi të automjetit në një hapësirë të përshtatur 2 armë zjarri automatike, 1 armë zjarri pistoletë, 1580 fishekë luftarakë të kalibrave të ndryshëm dhe 12 krehra fishekësh për armë automatike dhe pistolete.*
>
> *Nga veprimet hetimore dhe procedurale të kryera nga strukturat hetimore të DVP Durrës dhe asaj Kufitare të Portit Durrës për dokumentimin ligjor të kësaj ngjarjeje është bërë e mundur identifikimi dhe shpallja në kërkim e autorit të dyshuar të posedimit të armëve dhe të përfshirë në trafikimin e armëve dhe municioneve nga Kosova me destinacion Republikën Demokratike të Kongos.", njofton policia.*

Armët e zjarrit do të dërgohen edhe në Institutin e Policisë Shkencore për t'ju nënshtruar ekzaminimeve teknike, balistike dhe daktiloskopike për të parë nëse janë përdorur në ndonjë ngjarje kriminale të mëparshme.

Sakaq drejtoria e policisë Durrës, policia kufitare dhe Prokuroria po bashkëpunojnë me autoritetet në Kosovë për dokumentimin e plotë ligjor të këtij rasti me qellim identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

Xh.D/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: trafik armesh | porti i durresit | Durres | arme zjarri

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 7 Qershor, 22:45
Shqipëria barazoi me Serbinë, sa shanse ka për të shkuar në Botëror?

Shumë | Pak | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Aksident i shumëfishtë në autostradën Tiranë-Durrës, shkrumbohet nga flakët një makinë! Nuk dihet nëse ka të lënduar
8 Qershor, 10:58

'Motor Fest 4', Shijaku mikpret mbi 2 mijë motora nga 46 vende të ndryshme
Aldo Mustafa
7 Qershor, 17:38

Ekzekutimi i anëtarit të Avdylajve, Gjykata e Durrësit lë në burg 2 të arrestuarit! Ndihmuan autorët, 3 ende në kërkim
7 Qershor, 15:40

Turi në Mesdhe! 'MV Deutschland' ndalet në Durrës, kroçera sjell 463 turistë gjermanë që do vizitojnë atraksionet e qytetit (VIDEO)
Aldo Mustafa
7 Qershor, 09:46

Kalaja për Report Tv: Më janë vjedhur votat, kam parë pamjet filmike të marra nga KQZ! S'jam ushtar rreshti, shumë njerëz në PD duhet të hapin krahun pas dështimit
6 Qershor, 18:14

Festa e Kurban Bajramit/ Video me dron, kur besimtarët falin namazin në Durrës dhe Elbasan
6 Qershor, 12:09

Festa e Kurban Bajramit, besimtarët myslimanë falin namazin në Durrës
6 Qershor, 07:58

Kuçana për Report Tv: Lufta ime për dinjitet dhe jo për mandat, kam prova për devijimin e votës brenda PD-së
5 Qershor, 21:57

Shoferi keqtrajton gomarin në Gjirin e Lalzit, e tërheq me litar pas makinës (VIDEO)
5 Qershor, 16:51

VIDEO/ 'Defender Europe 25', anijet e helikopterët e Forcave të Armatosura 'pushtojnë' brigjet e Durrësit! Stërvitje edhe me dronë
Aldo Mustafa
5 Qershor, 11:12

KAS jep nesër vendimin për Kukësin! Fieri dhe Durrësi shtyhen për javën e ardhshme, marrin pjesë dhe dy kandidatët e PD, Kalaja dhe Kuçana
4 Qershor, 20:29

Turisti anglez ra nga motorri i ujit dhe u mbyt, Gjykata e Durrësit nxjerr nga qelia Luis Xhumarin! Caktohet me 'arrest në shtëpi'
4 Qershor, 14:34

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje